VENDIM
Nr. 699, datë 10.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 608, DATË 29.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË, SI PASOJË E COVID-19"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e kreut II, të vendimit nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi për programet, sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të kreut III, janë të gjithë punëkërkuesit e papunë që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID-19, të evidentuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të regjistruar në zyrën e punësimit. Ndërsa, punëkërkuesit me të drejtë përfitimi për programin, sipas shkronjës "c", të pikës 2, të kreut III, janë ata të cilët deklarojnë që kanë qenë të punësuar, por nuk evidentohen si të tillë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe regjistrohen në zyrën e punësimit.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe